



# KOSTT Transmission Grid Strengthening Project

<b>Vendndodhja:</b>	KOSOVA
<b>ID i Projektit:</b>	56091
<b>Sektori i Biznesit:</b>	Energjia
<b>Lloji i Njoftimit:</b>	Publik
<b>Kategoria Mjedisore:</b>	B
<b>Data e aprovimit:</b>	13 Maj 2026
<b>Statusi:</b>	Explorues
<b>Data e publikimit:</b>	24 Mars 2026

## Përshkrimi i Projektit

Një hua deri në 42.5 milionë € në favor të AKG Tucep ("Tucep") dhe AKG Veriq ("Veriq") (së bashku, "Huamarrësit"), shoqëri me qëllim të veçantë të inkuorporuara në Kosovë. Huaja do të dedikohet për ndërtimin dhe operimin e dy centraleve diellore fotovoltaike (PV) ngjitur në komunën e Istogut në Kosovë, me një kapacitet të instaluar të kombinuar deri në 142 MWp ("Projekti"). Pas përfundimit të ndërtimit, Projekti pritet të jetë portofoli më i madh i energjisë diellore PV në vend. Projekti është në pronësi të Quant Renewables (52%) dhe Green Growth Fund S.A. (48%). Projekti përfiton nga programi i garancisë Fondi Evropian për Zhvillim të Qëndrueshëm (EFSD+) për mbulimin nga humbjet e pritshme (first loss risk cover). Programi kontribuon në tranzicionin e ekonomive në Fqinjësinë Evropiane (European Neighbourhood) duke mbështetur investime të qëndrueshme në tranzicionin energjetik.

## Objektivat e Projektit

Projekti do të kontribuojë në zbutjen e ndryshimeve klimatike duke shtuar kapacitete të reja të prodhimit të energjisë diellore në sistemin energjetik të Kosovës. Kapaciteti shtesë do të ndihmojë në nxitjen dhe përshpejtimin e zhvillimit të energjisë diellore në shkallë të gjerë, duke diversifikuar kështu përzierjen aktuale të prodhimit, e cila dominohet nga linjiti. Përveç kësaj, Projekti do të nxisë pjesëmarrje më të madhe të sektorit privat në tregun e energjisë, i cili është kryesisht i dominuar nga ndërmarrjet shtetërore.

## Ndikimi I Tranzicionit

ETI vlerësimi: 80

Projekti kontribuon në tranzicionin “e gjelbër” duke mbështetur ndërtimin e një impianti diellor fotovoltaik (PV) me kapacitet prej 142 MWp. Ky kapacitet i ri do të rrisë peshën e energjisë së ripërtrishme në strukturën e prodhimit energjetik të Kosovës dhe pritet të sjellë kursime vjetore prej rreth 190 mijë tonësh CO<sub>2</sub>.

Projekti është në përputhje të plotë me Strategjinë e BERZH-it për Kosovën, e cila vendos theks të veçantë në zhvillimin e projekteve të energjisë së ripërtrishme. Gjithashtu, ai është vlerësuar si i përputhshëm me objektivat e Marrëveshjes së Parisit për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, në përputhje me metodologjinë e BERZH-it për harmonizimin e investimeve të financuara drejtpërdrejt me këtë marrëveshje.

Për më tepër, i gjithë financimi nga BERZH-i klasifikohet si financim i gjelbër, pasi Projekti mbështet aktivitete që synojnë uljen e emetimeve të gazrave serrë.

## Informacion mbi Klientin

Huamarrësi, Tucep dhe Veriq, janë shoqëri me qëllim të veçantë të themeluara në Kosovë për ndërtimin dhe operimin e dy centraleve diellore fotovoltaike, me një kapacitet të përbashkët të instaluar prej 142 MWp.

Quant Renewables është një platformë investimi dhe zhvillimi në fushën e energjisë së rinovueshme me bazë në Mbretërinë e Bashkuar, e themeluar në vitin 2025. Ajo operon në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe në disa tregje të përzgjedhura të Bashkimit Evropian, përfshirë Kosovën, Maqedoninë e Veriut, Shqipërinë dhe Italinë. Kompania mbështetet nga aksionarë me përvojë të gjerë në projekte të mëdha ndërtimi dhe në sektorin e investimeve financiare.

Green for Growth Fund (GGF) është një fond ndikimi me financim të kombinuar, i themeluar në vitin 2009 për të mbështetur investimet në energji të rinovueshme dhe në efikasitet të energjisë në Evropën Juglindore dhe Lindore, si dhe në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut. I menaxhuar nga Finance in Motion, GGF administron mbi 1 miliard euro asete dhe ka një histori të konsoliduar në financimin e projekteve të energjisë diellore, të erës dhe formave të tjera të qëndrueshme të energjisë.

## Përmbledhje e Financimit nga BERZH

EUR 42,500,000.00

## Kosto totale e projektit

EUR 98,204,000.00

## Shtesë

Shtesa e vlerës së BERZH-it qëndron në aftësinë për të strukturuar financim projektsh me regres të kufizuar, duke mundësuar realizimin e investimeve që mbështeten kryesisht në çmimet e tregut dhe duke tërhequr pjesëmarrjen e bankave komerciale.

Gjithashtu, ajo luan një rol të rëndësishëm në zbutjen e rreziqeve jofinanciare, si rreziqet e lidhura me vendin, kuadrin rregullator, zhvillimet makroekonomike dhe faktorët politikë, si dhe në sigurimin e financimit në një treg me thellësi dhe likuiditet të kufizuar për projekte të mëdha të energjisë së ripërtrishme.

## Përmbledhje Mjedisore dhe Sociale

**Kategoria B (ESP 2024).** Rreziqet mjedisore dhe sociale që lidhen me ndërtimin dhe operimin e Projektit, së bashku me infrastrukturën përkatëse, janë vlerësuar përmes analizës së kujdesit të duhur mjedisor dhe social (ESDD), e cila konfirmoi se rreziqet janë specifike për vendndodhjen dhe mund të menaxhohen në mënyrë efektive përmes zbatimit të Planit të Veprimit Mjedisor dhe Social (ESAP). Projekti ka përfunduar gjithashtu Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) sipas legjislacionit kombëtar dhe ka marrë miratimet nga autoritetet kompetente.

ESDD është kryer nga një konsulent i pavarur i angazhuar nga Banka dhe ka përfshirë shqyrtimin e VNM-së kombëtare (e miratuar në vitin 2023), dokumentacionit të lejeve, projektimit teknik, marrëveshjeve të tokës, dokumentacionit të angazhimit të palëve të interesit si dhe vizita në terren. ESDD konfirmoi se Projekti nuk ndodhet në zona të ndjeshme mjedisore apo të mbrojtura.

ESDD ka konkluduar se Projekti është në përputhje me legjislacionin kombëtar për mjedisin, shëndetin dhe sigurinë dhe është strukturuar për të përmbushur Kërkesat Mjedisore dhe Sociale të Bankës (ESR) përmes praktikave dhe sistemeve të mira të menaxhimit M&S, zbatimit të ESAP dhe monitorimit të vazhdueshëm.

Yenelsis (Solar Apex) është përzgjedhur si kontraktori EPC dhe do të mbajë përgjegjësinë gjatë fazës së ndërtimit dhe fazës fillestare të operimit, me politikat e saj korporative të transferuara tek Huamarrësi. Yenelsis ka realizuar mbi 700 MW projekte fotovoltaike nën kontrata EPC dhe zotëron certifikime ndërkombëtare, përfshirë ISO 9001, ISO 14001, ISO 45001, ISO 50001 dhe ISO 10002. Korniza e saj e brendshme përfshin procedura për shëndetin dhe sigurinë në punë (përfshirë aktivitetet me rrezik të lartë dhe mbikëqyrjen e nënkontraktorëve), pjesëmarrjen dhe konsultimin e punonjësve, sjelljen etike, parandalimin e punës së detyruar dhe punës së fëmijëve, anti-korrupsionin dhe anti-ryshfetin, si dhe menaxhimin e mbetjeve (përfshirë mbetjet e rrezikshme dhe WEEE). Kompania zbaton gjithashtu një proces të strukturuar të vlerësimit të zinxhirit të furnizimit që përfshin kritere mjedisore dhe sociale, ndërsa praktikat për Dhunën dhe Ngacmimin me Bazë Gjinore (GBVH) do të forcohen më tej sipas ESAP.

Megjithëse sistemi aktual i Yenelsis ofron bazë për kujdesin e duhur në zinxhirin e furnizimit, një hartë plotësisht e centralizuar e gjurmueshmërisë dhe verifikimi i qëndrueshëm në të gjithë furnizuesit dhe nënfurnizuesit ende nuk janë zbatuar dhe do të kërkohen sipas ESAP. Vlerësimi specifik i projektit ka përfshirë gjithashtu shqyrtimin e rreziqeve potenciale në zinxhirin e furnizimit të paneleve diellore deri në nivelin e silikonit metalurgjik, pa evidentuar prova të punës së detyruar.

Vendndodhjet karakterizohen kryesisht nga toka bujqësore e kultivuar intensivisht me ndjeshmëri të ulët ekologjike; nuk janë identifikuar Veçori Prioritare të Biodiversitetit apo Habitat Kritik brenda zonës së Projektit, dhe rreziqet e biodiversitetit janë të kufizuara dhe menaxhueshme.

Toka e Projektit është në pronësi shtetërore dhe do të sigurohet përmes marrëveshjeve afatgjata të qirasë. Rreth 126 hektarë në vendndodhjen Veriq përdoren aktualisht nga përdorues joformalë bujqësorë. Nuk pritet zhvendosje fizike, por humbja e përkohshme e aksesit mund të sjellë ndikime në jetesë. Huamarrësi ka nisur konsultimet dhe do të zbatojë masa proporcionale për rivendosjen e jetesës, në përputhje me ESAP.

Ndikimet gjatë ndërtimit (pluhur, zhurmë, trafik dhe rreziqe në shëndet dhe siguri) do të menaxhohen përmes planeve përkatëse, ndërsa ndikimet gjatë operimit pritet të jenë minimale. Menaxhimi i mbetjeve, shëndetit dhe sigurisë në punë dhe masat emergjente do të jenë në përputhje me praktikën ndërkombëtare.

Nuk janë identifikuar objekte të trashëgimisë kulturore dhe do të zbatohet procedura për Gjetje të Rastësishme (Chance Finds Procedure).

Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit (SEP) dhe Përmbledhja Jo-Teknike (NTS) janë përgatitur për publikim, së bashku me një mekanizëm ankese, duke përfshirë kanale konfidenciale për raportimin e GBVH.

Është rënë dakord ESAP që përfshin masa për rivendosjen e jetesës, forcimin e menaxhimit të kontraktorëve dhe punës, masa për GBVH dhe monitorim të vazhdueshëm nga Këshilltari Mjedisor dhe Social i Huadhënësve.

## **Bashkëpunimi Teknik dhe Financimi përmes Grantit**

Projekti pritet të përfitojë nga një mekanizëm garancie për mbulimin e humbjes së parë (first-loss) në kuadër të programit të garancisë Hi-Bar të Fondit Evropian për Zhvillim të Qëndrueshëm Plus (EFSD+). Gjithashtu, programi EFSD+ do të mbulojë kostot e Projektit që lidhen me vlerësimin teknik, mjedisor dhe ligjor (due diligence).

## **Informacion Kontaktues i Kompanisë**

Sinan Kurtoglu  
sinan.kurtoglu@quantrenewables.com

## **Ndikimi në Tranzicion**

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

## **Mundësitë e biznesit**

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: [projectenquiries@ebrd.com](mailto:projectenquiries@ebrd.com)

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni [Prokurimet e BERZH](#):

Tel: +44 20 7338 6794

Email: [procurement@ebrd.com](mailto:procurement@ebrd.com)

## Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

## Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS](#) dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikën e BERZH në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

## Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime prr praktika

mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek [compliance@ebrd.com](mailto:compliance@ebrd.com). Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

## Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalo informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke [përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH](#).

## Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH.

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me [Politikën Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së Qasjes në Informacion](#); dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për [Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit](#) për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të [dërguar një kërkesë](#) për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit [ipam@ebrd.com](mailto:ipam@ebrd.com) për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.